

ÇELJETA NIKOLLA

**VEÇORI TË FRAZEOTERMAVE NË DISKURSIN PUBLIK
SIPAS PËRKATËSISË GJINORE**

Prëzimi i sistemit diktatorial, solli një frymë të re në politikën shqiptare. Tashmë Shqipëria, nuk kishte më, një *qeveri kukull*, pre e kthetrave idealiste të një drejtuesi për të cilin skena politike ishte thjesht një skenë teatri dhe aktorët politikë ishin marionetat e tij. Ndryshimet demokratike në të cilat u përfshi vendi ynë sollën realisht në skenën politike edhe gruan shqiptare. Pushteti politik ka qenë i pozicionuar në duart e burrave, dhe skena politike e mediatike kanë qenë me natyrë mashkullore. Në to ka munguar në mënyrë të dukshme *zëri i grave*.

Jo vetëm pjesëmarrja, por edhe shqetësimet dhe problemet që sjellin gratë në diskursin e tyre janë të ndryshme nga burrat. Kështu, ato e ngrënë më shumë zërin për të drejtat e gruas, për barazinë gjinore, për dhunën në familje e shoqëri, për shkollimin e femrës shqiptare dhe përfshirjen e saj në jetën shoqërore.

Një tjetër risi prej tyre, përveç sjelljes së një pjese të problematikave të gjinisë së tyre në veçanti, por dhe gjithë shoqërisë, në përgjithësi, është edhe gjuha e përdorur. Sido që të përkufizohet politika, ajo ka një përmasë gjuhësore, diskursive, komunikative gjinore.

Duke u bazuar në studimet më të rëndësishme në këtë fushë, mund të themi se gratë përdorin më shumë fjali të bashkërenditura, gjuhë standarde, forma linguistike të tilla, si: “*ndoshta, e marr me mend, besoj se po*“, etj. Ato bëjnë kapërcime të temës, përdorin fjalë të reja dhe janë më të hapura ndaj ndryshimeve gjuhësore sesa burrat. Gjithashtu, tek gratë hasim një fjalor të posaçëm, terma dhe ngjyime, si edhe fjali pyetëse, fjalë parazitare, mbiemra të shkallës sipërore dhe shumë ndajfolje. Burrat përdorin një gjuhë të drejtpërdrejtë, përgjigje minimale, fjali më pak të ndërlikuara, gjuhë vulgare dhe ligjërim progresiv.

Në stilin gjuhësor të femrave politikane vëmë re tone më të zbutura dhe një fjalor edhe më të zgjedhur, saktësi më të madhe në përdorimin e gjuhës standarde.

Veçori të frazeotermave te gratë politike

Duke qenë se gratë janë më të ndjeshme se burrat për nevojat e të adresuarve, kjo shprehet e manifestohet përmes përdorimit të dendur të metaforave në gjuhën e tyre, por dhe në përbërje të frazeotermave. Në fragmentet e diskursit politik në Shqipëri, metaforat janë mbizotëruese në debatet publike, jo vetëm për nga denduria e përdorimit, por edhe për faktin se ato formësojnë konceptimin e temave politike. Nga ana tjetër ato u krijojnë mundësinë folësve të shprehin dhe nënkuptojnë qëndrime e pikëpamje nga më ekstremet, nën petkun e një ligjërimi “të ngjyrosur subjektivisht”. Ja disa prej tyre përdorur në ligjërimi politikanesh:

- **A. Jahjaga:** *Në përpjekje për të lehtësuar këtë barrë, jam përkushtuar për ndërtimin e një qendre pediatrike...gur themeli i të cilës do të vihet brenda pak muajsh”.*

- **J. Topalli:** *“Nga vendi i rrethuar me tela me gjemba, me një izolim të çmendur”.*

- **M. Bregu:** *“Nuk ngjit sepse artikuli politik është sa i papërgjegjshëm aq dhe i rrezikshëm, por edhe hileqar dhe e keqja tjetër më e madhe është se për gomone shpëtimi zgjedh kandidatët apolitike.”; “...është drita jeshile në fund të tunelit të gjatë e të errët të ndarjes sonë shekullore nga Europa!...”; “...PD-së i humbi gjysma e grupit, në errësirën totale ku u përpiluan listat e deputetëve dhe ju nuk u mblodhët të gjeni fajtorin”; “...për t’i vënë kurorën e dafinës “fitimtarit”...”.*

- **E. Gjëbrea:** *“Mos harroni që në 2013-ën Shqipërinë e gjetëm në listën e vendeve të zeza”.*

- **M. Doda:** *“... Ju kanë zgjedhur projekt pilot. Familjet tuaja si kavje”; “...PDIU-në nuk e përdorni dot as si asi nën mëngë, as si shkak suksesi apo fatkeqësie...”*

- **N. Malaj:** *“Përndjekje të shtrigave”: “..., po ju sjellë në kujtesë fjalët e Isabelle Huppert, mbajtur në Ditën Botërore të Teatrit: “Pasi që gjendem në Paris, në prag të zgjedhjeve presidenciale, u apeloj atyre që do të marrin pushtetin, të jenë koshient për përfitimet e paimagjinueshme që sjell teatri. Por, kujdes, pa përndjekje të shtrigave!”*

Tipar tjetër i frazeotermave në ligjërimin e grave, janë përdorimi i mbiemrave në shkallën sipërore si: **A. Jahjaga:** *“... ashtu edhe me vendet fqinje dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë, që qëndruan pranë nesh në periudhën tonë më të errët”.*

Shpesh, frazeotermat e grave të huaja politike përdoren si kalke nga politikanet shqiptare, p. sh: **White Paper** ~ “Dokument qeveritar” të cilit i referohen dy britaniket në fjalimet e tyre, M. Theçer dhe T. Mei, tek

politikanet shqiptare e gjejmë në forma të ndryshme si: **Kartë politike**: “Referendumi është një **kartë politike** ...” tek E. Meksidhe me një referim më ironik **Fletë-palosje**: “Pasi lexova me kujdes programin e kabinetit tuaj vërejtja me keqardhje të thellë se ky dokument nuk është gjë tjetër veçse një **fletë-palosje propagandistike**...”.

Ato i referohen edhe një lloj frazeotermi drejtuar gjinisë tjetër:

- **J. Topalli**: “Historia e Shtetit Shqiptar që nis nga Kongresi i Lushnjës, është jo vetëm histori e **burrave t’shtetit**...”.

- **A. Vokshi**: “Mirënjohje dhe admirim për **burrin e shtetit** që i dha Shqipërisë dhe Shqiptarëve dhuratën më të çmuar lirinë!”

Gratë përdorin edhe frazeoterma të futura rishtazi në politikën shqiptare:

- **E. Kushi**: **Ligji i Vetingut / procesi i vetingut**: “... **Ligji i Vetingut** është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

- **E. Meksi**: “...Megjithëse, sikurse dihet Britania nuk është në Eurozonë dhe as në **zonën Shengen** ...”.

- **J. Topalli**: “Ne shqiptarët jemi përfituesit më të lumtur nga **Marrëveshja e Shengenit**”.

- **E. Meksi**: “Komisioni European për Demokraci Nëpërmjet Ligjit, i njohur më mirë si **Komisioni i Venecias** ...”

- **E. Kushi**: “...Ne nuk kemi patur asnjëherë as më të voglin dyshim, por sidomos tani, pas opinionit të **Komisionit të Venecias**...”.

- **E. Gjebrea**: “...në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i **Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit**.”; “... ndër to vlen të përmendet: **Konventa e Parisit**”.

- **J. Topalli**: “Ndjehem e privilegjuar të ndaj me ju, pak kilometra larg Memorialit të **Murit të Berlinit**...”.

- **E. Meksi**: “Një fjalim i Kryeministrit britanik David Cameron për Europën e Bashkuar, mbajtur në Londër më 23 Janar ka bërë shumë bujë jo vetëm në **BE**, por edhe më gjerë ...”

- **J. Topalli**: “Shqipëria nuk është ende vend anëtar i **Bashkimit European**...”.

- **V. Hysi**: “...respekti për paratë e taksapaguesve të **Shteteve të Bashkuara të Amerikës** dhe vendeve të **Bashkimit European** shprehet jo duke bërë një rezolutë të tillë”.

- **O. Xhaçka**: **BE**: “...në shtabet ndërkombëtare, në operacionet e NATO, **BE** dhe OKB...”.

Veçori e frazeotermave të përdorura nga gratë janë dhe ato për çështje sociale.

Të drejtat e grave ka qenë kryefjala e shumë fjalimeve të grave politikanë, ku njëra ndër to, **A. Jahjaga** në fjalimin e saj në Samitin Global të Grave në Francë, kërkon të zgjojë ndërgjegjen njerëzore dhe të tregojë se përfaqësimi i gruas në instancat shtetërore është një nevojë dhe domosdoshmëri. Ajo ka përdorur frazeotermen e pjesshëm “*barazi gjinore*”, frazë e ndjekur edhe nga deputetet shqiptare në vijim:

- “*Me të vërtetë, në shumë vende të botës kemi parë se si lidershipi ka përcaktuar shpejtësinë e arritjes së **barazisë gjinore** dhe si zhvillimi i vendit ka qenë i lidhur me fuqizimin social, ekonomik dhe politik të grave...*”.

Po me të njëjtën vendosmëri e gjejmë edhe tek fjalimi i **E. Gjermanit** në konferencën “*Rritja e rolit të gruas në sferën publike, politike dhe ekonomike*”, organizuar nga OSBE në Monako, në të cilën ajo përmend këto frazeoterma:

“*Do të ishte një histori mbi luftën e shoqatave të grave për të promovuar **barazinë gjinore** në Shqipëri;*”.

- **M. Doda**: “*Ditën e enjte, dt. 12 mars në OKB, seanca për **barazinë gjinore** me temën bashkëveprimi me **djes** dhe përfaqësimin e gruas në Shqipëri*”.

Përdorimi i frazeotermave në fushën e ekonomisë e gjejmë të referuar në fjalimin e saj të politikanës **A. Dhima**: “*... rritjen e turistëve e të vizitorëve me potencial të **fuqisë blerëse**, që do të vijë në Shqipëri, si dhe rritjen e konsumit*”. Frazeotermi **fuqi blerëse** ~ konsumatorët, populli.

Nga ana leksiko-semantike kemi bërë një veçim të frazeotermave bazuar mbi transparencën kuptimore, mbi figurshmërinë, duke i ndarë në dy kategori:

a. Frazeoterma me figurshmëri të pjesshme.

1. **Ari i zi** ~ nafta.
2. **Barazi gjinore** ~ nënkupton barazinë e burrave, grave dhe personave me identitete të ndryshme gjinore në jetën shoqërore dhe politike.
3. **Dritë jeshile** ~ mundësi, shans për të vepruar.
4. **Fuqi blerëse** ~ konsumatorët, populli.
5. **Fuqitë e Mëdha** ~ Shtete të cilat kishin pushtetin dhe drejtimin.

6. **Gur themeli** ~ një çështje e rëndësishme dhe thelbësore.
7. **Këmbanë alarmi** ~ situatë e vështirë, alarmante.
8. **Kurorë dafinash** ~ fitim i lavdishëm.
9. **Periudha më e errët** ~ Kohë politike dhe historike të vështira që kalon një vend.
10. **Spastrim etnik** ~ është emri i përgjithshëm i metodave të paligjshme, kur njëra nga palët në konflikt në mënyrë sistematike përjashton ose vret civilë për shkak të përkatësisë së tyre fetare apo etnike.
- a. **Frazeoterma me figurshmëri të plotë:**
 10. **Errësirë totale** ~ mosveprim.
 3. **Tel me gjemba** ~ pengesë për të arritur diçka; izolim.
 4. **Shkopinj nën rrota** ~ pengesë kundërshtarit për të dështuar, për të mos korrur sukses.
 5. **Qark /rreth vicioz** ~ është procesi në të cilin një person që përpiqet të zgjidhë një problem është përballur me një problem të ri që çon në një fund të vdekur
 6. **Projekt Pilot** ~ vend prove.
 7. **Programi pilot** ~ program prove.
 8. **Gomone shpëtimi** ~ zgjidhje e një problemi.
 9. **Tryezë e bisedimeve; tryezë dialogu** ~ takim i rëndësishëm midis krerëve të një vendi për të biseduar për një çështje të rëndësishme.
 11. **As nën mëngë** ~ mundësi rezervë.
1. **Ligji i vetingut / procesi i vetingut** ~ Ligji i Vetingut: vetting, kontrolli i imtësishëm i figurës së dikujt përpara se t'i ofrohet një pozicion pune, një titull, një çmim, etj.
2. **Përndjekje të shtrigave** ~ asgjësimi i kundërshtarëve për t'i hapur rrugë vetes.

• **Frazeotermat e politikaneve shqiptare në seancat parlamentare.**

Në studimin tonë, një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe frazeotermave të përdorura në seancat parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, ku zëri i gruas është dëgjuar në diskutime të projektligjeve të ndryshme. Ne jemi bazuar në të njëjtin korpus diskutimesh që ka patur edhe për politikanët meshkuj për të bërë një krahasim të frazeotermave në tema të njëjta diskutimi si ajo e: *Ligjit të vettingut, projektligji mbi krijimin e një landfilli në Shqipëri dhe miratimin e projektbuxhetit të shtetit*, që përkojnë me periudhën e vitit 2016-të. Aty ne kemi dalluar dhe veçuar këto frazeoterma:

• Frazoterma politiko-letrare

1. **“Sistem i kalbur”** ~ Drejtimi politik. “... si rrjedhojë e nevojës së madhe për ndryshime rrënjësore që ka shoqëria jonë dhe **sistemi i kalbur** në të cilin e gjetëm”, **B. Gjylameti**.

2. **“Krizë Helenike”** ~ Kriza e Greqisë, “A e kuptoni se ç’do të thotë? Ky vend po shkon drejt fundit. Sindroma e **krizës helenike** është afruar ...”, **J. Topalli**.

3. **“Lideri global”** ~ iron. E. Rama. “Ne jemi një komb në hall të madh, një komb si asnjë tjetër në Europë, ndërkohë ky **“lideri global”** del në medie – për turpin e tij dhe tonin! – dhe tregon se ç’zgjidhje duhet të bëjë Amerika, ndërkohë ne jemi groposur në krim.””, **J. Topalli** (po aty).

4. **“Një milionë shuplakave”** ~ qortimeve e dënimeve për keqqeverisje. “Ky është viti i fundit i qeverisjes së **“një milion shuplakave”** dhe shikoni se ku është katandisur mazhoranca e 83 votave - me të blerë 85 vota”, **J. Topalli**.

5. **“Ëndrra në beze”** ~ të parealizueshme. “...kështu siç ndoshta e kanë disa nga ne të opozitës, se programi i artikuluar nga kjo qeveri, e cila dikur quhej “Rilindje”, sot është, ashtu siç thonë disa nga zona ime, veçse **ëndrra në beze**.””, **J. Tabaku**.

6. **“Provë e gjallë”** ~ “Mora shkak, në fakt, nga një ofendim që Kryeministri, si gjithmonë, ... zonjës Mimoza, e cila sot më dha **provën e gjallë**,...”, **L. Elmazi**.

7. **“Avazi i vjetër”** ~ “Ne nuk zgjodhëm **avazin e vjetër**, por rrugën e punës dhe të reformave për të ndërtuar sistemin arsimor të gjeneratës tjetër.” **L. Nikolla**.

8. **“Avazi i vjetër”** ~ “Pra, avazi i drogës është një **avaz i vjetër** në të cilin opozita ka dështuar prej kohësh.””, **E. Felaj**.

9. **“Fjalë boshe”** ~ “Në fakt, unë nuk kisha lexuar kurrë një relacion me më shumë retorikë, me demagogji dhe me **fjalë boshe**.””, **J. Tabaku**.

10. **“Lugë boshe”** ~ “Janë plot 100 milionë dollarë në dispozicion për këtë qëllim, që për herë të parë nuk po i marrim borxh si ju për t’ua dhënë më pas, si një **lugë boshe** shqiptarëve”, **E. Felaj**.

11. **“Mure ndarëse”** ~ “Punuar për t’i kthyer shkollat në një qendër të rëndësishme në komunitet dhe jo të rrethuara me **mure ndarëse** për prindërit dhe komunitetin...””, **L. Nikolla**.

12. **“Kolona informuese”** ~ Institucionet shtetërore. “Gjithashtu, është vendosur një dialog më i madh me biznesin dhe gjatë këtij viti janë zhvilluar rreth 30 takime, duke përdorur më së miri disa nga **kolonat**

informuese, si Këshillin e Investimeve, Komitetin e Lehtësimit të Tregtisë dhe Këshillin Ekonomik Kombëtar.” **M. Konomi.**

13. **“Ironi e fatit”** ~ “Dhe, si për **ironi të fatit**, në vend të refrenit qesharak rilindës “Fajin e ka Saliu”, i kënduar përditë këta tre vjet, nuk është çudi të dëgjojmë refrenin “Rroftë Saliu”, **L. Elmazi.**

14. **“Masterplan Kombëtar”** ~ reformë politike. “Sërish, me financimin e qeverisë gjermane, nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim, do të bëhet i mundur hartimi i **masterplanit kombëtar** në fushën e mbetjeve, një instrument i nevojshëm që plotëson paketën për krijimin e një sistemi të integruar të mbetjeve në Shqipëri”, **E. Gjermeni.**

15. **“Procesi i Vetingut”** ~ Reforma në drejtësi. “E rëndësishme është që ne nuk jemi pengje të kalendarit, thotë Lajçak, por do t’i kthehemi progresit të Shqipërisë në çdo moment që do të shikojmë se ka prova të mjaftueshme lidhur me zbatimin e **procesit të vetingut**” Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme dhe ajo që ne e kemi quajtur **“mekanizmi urë”** është një pozitivitet për Shqipërinë”, **A. Dade.**

16. **“Ligji i Vetingut”** ~ Reforma në drejtësi. “... pasi po mbledhemi në këtë ditë fundgushti për të kaluar ligjin për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, siç quhet ndryshe **ligji i vetting-ut**,...” **M. Doda.**

17. **“Grusht shteti”** ~ Kryengritje. “Ky është sistemi i drejtësisë, të cilin, aktorët që e krijuan e frymëzuan të mos japë drejtësi për **grushtin e shtetit** të vitit ‘98, për krimin shtetëror të Gërdecit dhe vrasjet e 21 janarit.” **A. Dade.**

18. **“Lista e Gjelbër”** ~ lista e materialeve të riciklueshme. “Ne nga 430 elemente të rrezikshme e çuam këtë listë në 55 elemente të marra nga **Lista e Gjelbër** e miratuar, listë e gjelbër edhe e vendeve të tjera të BE-së”, **M. Bregu.**

19. **“Lojërat e fatit”** ~ Llotot; Mullinj ere ~ Llotot “E kush nuk e mban mend Sanço Pançon në betejën me bizneset e **lojërave të fatit**? A mund të më thotë dikush, çfarë ndodhi me këta **mullinj ere**? A u mbyllën? Akoma më komike ishte beteja e dytë, ku Don Kishoti doli bashkë me Sanço Pançon, ajo me kanabisin!”, **L. Elmazi.**

20. **“Propagandë rozë”** ~ “Sipas të dhënave të fundit që janë publikuar sot rreziku më i madh që deklarojnë bankat e nivelit të dytë, nuk janë as kolaterali, as kreditë e këqija, por është gjendja e përkeqësuar e ekonomisë, ndryshe nga **propaganda rozë** që po lexojmë këto ditë”. **J. Tabaku.**

- **Frazeoterma politiko-ekonomike**

1. **“Morsën e taksidarëve”, “Morsën e taksave”** ~ shumë taksa. “... pa folur për represionin sistematik ndaj bizneseve, të cilët përbuzen, duke kaluar në **morsën e taksidarëve**, në **morsën e taksave**...”. **J. Tabaku.**

2. **“Fuqi blerëse”** ~ “Ndaj, kemi arritur aty ku jemi sot: vendi me pagën minimale dhe me **fuqinë blerëse** më të ulët në Europë, ...”, **L. Elmazi.**

3. **“Taksë e sheshtë”** ~ “Shqipëria, nga viti 2008-2013 raportohet se e ka ulur hendekun mes shtresave sociale me tipikë përqindje, si rezultat i **taksës së sheshtë**.”, **J. Tabaku.**

4. **“Treg i lirë”** ~ “Në buxhetin e vitit 2016 u siguria pagesa e qirasë **në treg të lirë**, duke u ardhur në ndihmë shtresave relativisht në nevojë”, **K. Spahiu.**

5. **“Stanjacion ekonomik”** ~ ndalesë, “Ulja e ndjeshme e investimeve në ekonomi është tregues i qartë i **stanjacionit ekonomik**, i humbjes së besimit për të investuar, i instalimit të frikës dhe pasigurisë gjatë këtyre 3 vjetëve të qeverisjes suaj.”, **L. Elmazi.**

6. **“Grant Konkurrues”** ~ “Në fund të fjalës sime do të doja të ndalesha shkurtimisht te mënyra se si do të disbursohet **granti konkurrues**”, **E. Gjermani.**

- **Frazeoterma politiko-sportive**

1. “Në përgjigje të propozimit të zonjës Bregu, e kemi diskutuar vërtet këtë mëngjes, por e vërteta është se ky projektligj ka dy muaj që bën **ping-pong** nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë të Komisioni i Ligjeve dhe bashkë me grupet e interesit,...”, **Olta Xhaçka.**

2. “Edi Rama dhe Saimir Tahiri janë kapur **“shah mat!”** me Emiliano Shullazin dhe nuk ka gjë që t’i shpëtojë, ndaj edhe ne nuk e ndalim betejën tonë kundër krimit dhe mafies.”, **J. Topalli.**

- **Përdorimi i shprehjeve frazeologjike**

- “...por ajo çka harrohej qëllimisht në diskutimet e radhës për buxhetin, llogaridhënie të së cilës **i jeni larguar si djalli temjanit**,...”, **Mimi Kodheli**

- “...kur doni **t’i bëni bisht të vërtetës**,...”. **M. Hafizi.**

- “...thënë ndryshe, **ta vinim kufirin te thana**; ishin ditë që politika shqiptare të krijonte njëfarë sëkëlldie, si pas festave të fundvitit, sepse dukej **sikur i ishte hapur thesi**.”, **M. Doda.**

- “**Gjithsecili e di vetë se ku i pikon çatia**”, thotë populli. çatia jote, mbase duhet edhe pak më shumë kurajë.”, **M. Bregu.**

- ***“Mjerimi ka veshur petkun njerëzor për 31% të shqiptarëve. Është skalitur në ballin e tyre.”***, L. Elmazi.
- ***“Faji u bë qyrk, por askush nuk e veshi, si gjithnjë iku në drejtim të paditur.”***, E. Qirici.

Përfundime

Në përfundim mund të themi se në këtë studim të mirëfilltë që ne kemi kryer, frazeotermat janë pjesë e fjalimeve të politikaneve femra po aq sa edhe të politikaneve meshkuj. Përgjithësisht frazeotermat janë të karakterit historik, politik dhe të fushave të ndryshme të jetës njerëzore. Nga ana sintaksore këto frazeoterma përmbajnë një përbërje elementësh të pandashëm, përçues të një mesazhi e kuptimi të ri. Nga ana morfologjike e përbërjes së tyre janë kryesisht me gjymtyrë emërore, mbiemërore dhe herë- herë me parafjalë.

Bibliografi

- *Tabaku, Jorida*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 62; f. 173;
- *Topalli, Jozefina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 17.03.2016, f. 78; f. 96; f. 150; f. 272.
- *Bregu, Majlinda*, Fjalim i mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë për fushatën zgjedhore.
- *Bregu, Majlinda*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesioni i shtatë E hënë, 05.09.2016. f. 200.
- *Dade Arta*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016. f. 169.
- *Dhima, Antoneta*, Kuvendi i Shqipërisë, LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 9 KORRIK 2018. f. 21-22.
- *Doda, Mesila*, Fjalim i mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me martesën e së njëjtës gjini.
- *Doda, Mesila*, Fjalim, Punime të Kuvendit Legjislatura e 8-të Viti 2016, nr. 4, f. 15.
- *Doda, Mesila*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesioni i shtatë E hënë, 05.09.2016. f. 202.
- *Doda, Mesila*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E martë, 30.08.2016, f. 11.
- *Elmazi, Liljana*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesioni i shtatë E enjte, 01.12.2016. f. 98- 99.

- *Elmazi, Liljana*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesion i shtatë E hënë, 05.09.2016. f. 202; f. 297- 298
- *Felaj, Ermonela*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 65.
- *Felaj, Ermonela*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E hënë, 05.09.2016. f. 76; f. 154.
- *Gjebrea, Elona*, Fjalim, e enjte 28.09.2017.
- *Gjermani, Eglantina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016. f. 117.
- *Gjylameti, Blerina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 17.03.2016, f. 17; f. 317.
- *Hafizi, Mimoza*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 83-84.
- *Hafizi, Mimoza*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 17.03.2016, f. 116.
- *Hajdarmataj, Mimoza*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 306.
- *Halimi, Arbjola*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 129.
- *Kodheli, Mimi*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016. f. 70.
- *Konomi, Milva*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016. f. 98.
- *Kushi, Evis, Fjalim*: “*Ligji i Vettingut i rëndësishëm, do shërbejë për të luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në çdo fushë*”, 15 Dec 2016.
- *Nikolla, Lindita*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 91-93.
- *Qirici, Eleina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesion i shtatë E hënë, 05.09.2016. f. 302.
- *Spahiu, Klodiana*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 105.
- *Tabaku, Jorida*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 17.03.2016, f .81.
- *Tabaku, Jorida*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E hënë, 05.09.2016. f. 263.
- *Topalli, Jozefina*, Fjalim i mbajtur në Fondacionit Konrad Adenauer në Gjermani për të reflektuar rreth sfidave të demokracisë në Shqipëri 25 vjet pas rënies së komunizmit.

Veçori të frazeotermave në diskursin publik sipas përkatësisë gjinore

- *Topalli, Jozefina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesioni i shtatë E enjte, 01.12.2016. f. 167; f. 244;
- *Topalli, Jozefina*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të Sesioni i shtatë E hënë, 05.09.2016. f. 74-75.
- *Vokshi, Albana*, Punime të Kuvendit, LEGJISLATURA E 8-të, E enjte, 01.12.2016, f. 77.
- *Xhaçka, Olta*, *Fjala e plotë e ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka me rastin e 20 - Vjetorit të Krijimit të Batalionit të Forcave Speciale, e diel, 21 tetor 2018 14:15.*

Linket

- <http://deputetim.al/wp-content/uploads/2018/03/Fjalimi-Hysi-08.02.2018.pdf>
- <http://telegraf.al/politike/prof-ermelinda-meksieuroskeptiket-problemet-e-be-se-dhe-shqiperia/>
- <http://www.gazetatema.net/2017/09/10/debati-ne-pd-reagon-majlinda-bregu-aman-mos-na-e-nxirrni-bojen-ja-lutja-ime/>
- <http://www.gazetatema.net/2018/04/17/bregu-uron-celjen-e-negociatave-thumbon-bashen-ngushellime-dikur-sulmoje-qendrimin-timndersa-sot-ngre-si-te-paqene-flamurin-e-luftetarit-pro-europian/17.04.2018>
- <http://www.kohajone.com/2018/11/24/protesta-e-unazes-se-re-nora-malaj-sot-po-shfaqet-nje-lufte-civile/>
- <http://www.ps.al/fjalime/fjala-ne-kuvend-e-deputetes-se-ps-ermelinda-meksi-19-03-2010>
- <http://www.standard.al/2018/07/05/nora-malaj-te-duash-vendin-do-te-thote-te-duash-dhe-te-mbrosh-teatrin-kombetar/>
- <https://pd.al/2015/12/fjalimi-i-kryetares-se-lidhjes-demokratike-te-gruas-albana-vokshi-ne-25-vjetorin-e-krijimit-te-pd/>
- <https://sot.com.al/politike/barazia-gjinore-mesila-doda-vizit%C3%AB-n%C3%AB-shba-foto-lajm>
- <https://telegrafi.com/ky-eshte-fjalimi-i-plote-i-presidentes-jahjaga-para-deputeteve/>

